



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.49

2005

23 qershor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9401 datë 19.5.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur”....	1753
Ligj nr.9402 datë 19.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes shtesë të huasë dhe të projektit, për marrëveshjen e huasë të datës 24 korrik 1999, ndryshuar me marrëveshjen shtesë të huasë dhe të projektit të datës 5 tetor 2002, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (Agjencia Zbatuese e Projektit) dhe KfW-së (Frankfurt am Main) për projektin “Furnizimi me energji elektrike për Shqipërinë jugore””.....	1760
Ligj nr.9403 datë 19.5.2005	Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”.....	1766
Ligj nr.9404 datë 19.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare”.....	1778
Vendim i KM nr.441, datë 16.6.2005	Për një shtesë në vendimn nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që	

	privatizohet, si dhe procedura e shitjes”, të ndryshuar.....	1783
Vendim i KM nr.451, datë 16.6.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet”, të ndryshuar.....	1784
Udhëzim i KM nr.4, datë 16.6.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.	1784

LIGJ
Nr.9401, datë 19.5.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN PËR NXITJEN E RESPEKTIMIT TË MASAVE NDËRKOMBËTARE TË MENAXHIMIT DHE TË RUAJTJES SË BURIMEVE NGA ANIJET E PESHKIMIT NË DET TË HAPUR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur”, bërë në Romë më 24.11.1993.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4608, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
PËR TË NXITUR RESPEKTIMIN E MASAVE NDËRKOMBËTARE TË MENAXHIMIT DHE RUAJTJES SË BURIMEVE NGA ANIJET E PESHKIMIT NË DET TË HAPUR

Palët në këtë Marrëveshje,

- *duke njohur* që të gjitha shtetet kanë të drejtën që anijet e tyre të peshkojnë në det të hapur, sipas rregullave të ligjit ndërkombëtar, ashtu siç përcaktohet në konventën e Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit,

- *duke njohur* gjithashtu që, sipas ligjit ndërkombëtar, ashtu siç përcaktohet në konventën e OKB-së në ligjin për detin, të gjitha shtetet kanë për detyrë të marrin ose të bashkëpunojnë me shtetet e tjera në marrjen e masave të tilla për anijet e tyre respektive kombëtare, të domosdoshme për ruajtjen e burimeve të gjalla në det të hapur,

- *duke njohur* të drejtën dhe interesin e të gjitha shteteve për zhvillimin e sektorit të tyre të peshkimit në përputhje me politikat e tyre kombëtare dhe të nevojës së nxitjes së bashkëpunimit midis vendeve në zhvillim, në rritjen e kapaciteteve të tyre për përmbushjen e detyrimeve që ato kanë, në bazë të kësaj Marrëveshjeje,

- *duke ditur* që Axhenda e 21-të e miratuar nga Konferenca mbi Mjedisin dhe Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara, u kërkon shteteve të ndërmarrin veprime efikase, në përputhje me ligjin ndërkombëtar, për të luftuar ndërrimin e flamurëve nga anijet e tyre si një mënyrë për shmangien e rregullave të ruajtjes dhe të menaxhimit për peshkimin në det të hapur,

- *duke ditur* gjithashtu që Deklarata e Kankunit e miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi peshkimin e përgjegjshëm, u kërkon shteteve të ndërmarrin veprime në këtë drejtim,

- *duke mbajtur* parasysh që sipas Axhendës 21, shtetet angazhohen për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve detare të gjalla në det të hapur,

- *duke u bërë* thirrje shteteve të cilat nuk marrin pjesë në organizatat ose grupimet globale, rajonale ose nënrajonale të peshkimit, të anëtarësohen ose më mirë të bashkëpunojnë me këto organizata, ose palët e këtyre organizatave ose grupeve, me qëllim përmbushjen e detyrimeve për zbatimin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese,

- *të vetëdijshëm* mbi detyrimet e secilit shtet në ushtrimin efektiv të juridiksionit dhe kontrollit mbi anijet që mbajnë flamurin e tij, duke përfshirë anijet e peshkimit dhe anijet e transportit të peshkut,

- *duke mbajtur* parasysh që praktikat e dhënies së flamurit dhe të ndërrimit të flamurit të anijeve të peshkimit, përdoren si një mënyrë për të shmangur zbatimin e ruajtjes ndërkombëtare dhe masave menaxhuese

për burimet detare të gjalla dhe që shtetet flamurbajtëse nuk përmbushin përgjegjësitë e tyre kundrejt anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e këtyre shteteve, janë ndër faktorët që seriozisht pengojnë efektshmërinë e këtyre masave,

- duke kuptuar që objektivat e kësaj Marrëveshjeje do të realizohen nëpërmjet përcaktimit të përgjegjësiave të shteteve flamurbajtëse kundrejt anijeve të peshkimit të pajisura me flamur nga ana e tyre dhe që veprojnë në det të hapur, duke përfshirë dhe autorizimet e lëshuara nga shtetet flamurbajtëse për këto aktivitete, ashtu sikurse nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjes së transparencës, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mbi peshkimin në det të hapur,

- duke nënvizuar që kjo Marrëveshje do të jetë pjesë e pandarë e Kodit Ndërkombëtar të Drejtimit për një peshkim të përgjegjshëm të aprovuar në Deklaratën e Kankunit,

- duke dashur të konkludojnë një Marrëveshje Ndërkombëtare në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin që këtë e tutje do të quhet FAO, sipas nenit XIV të Kushtetutës së FAO-s,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përcaktime

Në kuptim të kësaj Marrëveshjeje:

a) “Anije peshkimi” nënkupton çdo anije e përdorur ose që parashikohet të përdoret për shfrytëzimin industrial të burimeve të gjalla detare, duke përfshirë anijet mbështetëse dhe çdo anije tjetër të përfshirë në veprimtarinë e peshkimit;

b) “Ruajtje ndërkombëtare të burimeve dhe masa menaxhuese” nënkupton masa me qëllim ruajtjen ose menaxhimin e një ose më shumë llojeve të burimeve të gjalla detare, të cilat janë miratuar dhe zbatuar në përputhje me rregullat kryesore të ligjit ndërkombëtar siç parashikohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara të 1982 mbi ligjin për detin. Këto masa mund të miratohen gjithashtu nga organizatat globale, rajonale ose nënrajonale të peshkimit, objekte të të drejtave dhe detyrimeve të anëtarëve të tyre ose nga traktatet, ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare;

c) “Gjatësi” nënkupton:

i) për çdo anije të ndërtuar pas 18 korrikut 1982, 96% (për qind) e gjatësisë së përgjithshme mbi vijën e zhytjes në 85% (për qind) të zhytjes më të vogël të modeluar, e matur nga pjesa e sipërme e kallumës ose gjatësia nga pjesa ballore e bashit deri te vija e fletëve të timonit mbi këtë vijë zhytjeje, në qoftë se është më e madhe. Në anijet e ndërtuara me karenë të pjerrët, vija e zhytjes mbi të cilën matet gjatësia do të jetë paralele me vijën e zhytjes së projektuar;

ii) për çdo anije tjetër të ndërtuar para 18 korrikut 1982, gjatësia e regjistruar është, ashtu siç është e regjistruar në regjistrat kombëtarë ose regjistra të tjerë të anijeve;

d) “regjistër i anijeve të peshkimit” nënkupton një regjistër të anijeve të peshkimit, në të cilin janë të regjistruar të dhënat bazë të anijeve të peshkimit. Ai mund të përbëhet nga një regjistër i veçantë për anijet e peshkimit ose një pjesë e veçantë e një regjistri të përgjithshëm të anijeve;

e) “Organizatë integrimi ekonomik rajonal” nënkupton një organizatë integrimi ekonomik rajonal, së cilës vendet anëtare i kanë transferuar kompetenca mbi çështjet që mbulon kjo Marrëveshje, duke përfshirë autoritetin e marrjes së vendimeve detyruese për vendet anëtare të saj për zbatimin e këyre çështjeve;

f) “anije që kanë të drejtën të mbajnë flamurin e tyre” dhe “anije që kanë të drejtën të mbajnë flamurin e një shteti” përfshijnë anije që kanë të drejtën të mbajnë flamurin e një vendi anëtar të një organizate integrimi ekonomik rajonal.

Neni 2 Zbatimi

1. Në zbatim të paragrafëve të mëposhtëm të këtij neni, kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjitha anijet e peshkimit, të cilat përdoren ose do të përdoren për peshkim në det të hapur.

2. Një palë mund të përjashtojë anijet e peshkimit me gjatësi më të vogël se 24 metra, që përdorin flamurin e saj nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje deri kur pala përcakton që ky përjashtim nuk do të shkelë objektivat dhe qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, duke garantuar që këto përjashtime:

a) nuk do të merren parasysh ndaj anijeve të peshkimit që kryejnë aktivitet peshkimi në zonën e peshkimit të përcaktuar në paragrafin 3 të mëposhtëm, ndryshe nga anijet e peshkimit që kanë të drejtën të përdorin flamurin e një shteti bregdetar të asaj zone peshkimi;

b) nuk do të përfshijnë detyrimet e marra nga palët sipas paragrafit 1 të nenit 3 ose paragrafit 7 të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Pa asnjë paragjykim të klauzolave të paragrafit 2 të mësipërm, në çdo zonë peshkimi ku shtetet kufitare bregdetare nuk kanë deklaruar akoma zonë ekskluzive ekonomike ose zonë ekuivalente të juridiksionit kombëtar për peshkimin, këto shtete bregdetare, ashtu sikurse palët në këtë Marrëveshje mund të bien dakord ose drejtpërdrejt, ose nëpërmjet organizatave të peshkimit rajonal të përshtatshme, të vendosin një gjatësi minimale të anijeve të peshkimit në bazë të të cilit kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet ndaj anijeve të peshkimit që përdorin flamurin e secilit prej këtyre vendeve bregdetare dhe që veprojnë ekskluzivisht në këtë zonë peshkimi.

Neni 3

Përgjegjësitë e shtetit flamurmbajtës

1. a) Secila palë do të marrë masat e nevojshme me qëllim që të sigurojë që anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e saj të mos zhvillojnë asnjë aktivitet që dëmton efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese.

b) Në zbatim të pikës së mësipërme, një palë që ka bërë një përjashtim për anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e saj, më të vogla se 24 metra gjatësi, sipas paragrafit 2 të nenit 2, në zbatimin e kërkesave të kësaj marrëveshjeje, kjo Palë do të marrë masa efektive kundrejt çdo anijeje të tillë peshkimi që dëmton efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese. Këto masa duhet të jenë të tilla që të sigurojnë që një anije peshkimi të mos kryejë aktivitete që dëmtojnë efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese.

2. Në veçanti, asnjë palë nuk do të lejojë që një anije peshkimi, që mban flamurin e saj, të përdoret për peshkim në det të hapur në qoftë se nuk është e autorizuar të bëjë një gjë të tillë nga autoriteti kompetent ose autoritetet e asaj pale. Një anije peshkimi e autorizuar duhet të peshkojë në përputhje me kushtet e autorizimit.

3. Asnjë Palë nuk do të autorizojë një anije peshkimi që mban flamurin e saj të përdoret për peshkim në det të hapur, deri atëherë kur kjo palë të jetë në gjendje që, duke mbajtur parasysh lidhjet që ekzistojnë midis saj dhe një anijeje peshkimi si më sipër, të ushtrojë plotësisht përgjegjësitë e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj asaj anijeje peshkimi.

4. Atëherë kur një anije peshkimi, e cila është autorizuar të përdoret për peshkim në det të hapur nga një palë, përfundon së mbajtur flamurin e asaj pale, autorizimi i peshkimit në det të hapur do të konsiderohet i pavlefshëm.

5.a) Asnjë palë nuk do të autorizojë një anije peshkimi të regjistruar më parë në territorin e palës tjetër dhe që ka dëmtuar efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese, për t'u përdorur për peshkim në det të hapur, në qoftë se nuk plotëson këto kushte:

i) Të ketë përfunduar çdo periudhë pezullimi nga një palë tjetër i një autorizimi për këtë anije peshkimi, për t'u përdorur për peshkim në det të hapur; dhe

ii) Asnjë autorizim për këtë anije peshkimi për t'u përdorur për peshkim në det të hapur t'i jetë hequr nga një palë tjetër në tre vitet e fundit.

b) Klauzolat e nënparagrafit (a) të mësipërm do të zbatohen gjithashtu kundrejt anijeve të peshkimit të regjistruara më parë në territorin e një shteti, i cili nuk është palë në këtë Marrëveshje, me kusht që të ketë informacion të mjaftueshëm për palën në lidhje me rrethanat në të cilat autorizimi për të peshkuar është pezulluar ose hequr.

c) Klauzolat e paragrafëve (a) dhe (b) nuk do të zbatohen atëherë kur pronësia e anijes së peshkimit ka ndryshuar në vijim dhe pronari i ri jep garanci të mjaftueshme për të vërtetuar që pronari ose operatorët paraardhës nuk kanë më asnjë interes ligjor, përfitues ose financiar në pronësinë e kësaj anijeje peshkimi.

d) Me përjashtim të kërkesave të nënparagrafëve (a) dhe (b) të mësipërm, një palë mund të autorizojë një anije peshkimi, së cilës këto nënparagrafe mund t'i zbatohen ndryshe, që të përdoret për peshkim në det të hapur, atëherë kur pala në fjalë, pasi është njohur me faktet themelore, duke përfshirë rrethanat në të cilat autorizimi për peshkim është hequr nga një Palë ose shtet tjetër, përcakton që dhënia e një autorizimi për përdorimin e anijes për peshkim në det të hapur nuk do të cenojë objektivat dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Çdo palë do të sigurojë që të gjitha anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e saj dhe që janë regjistruar në regjistrin e mbajtur sipas nenit 4 janë të shënuara në atë mënyrë që të mund të identifikohen lehtësisht në përputhje me standardet e përgjithshme të pranuar, siç janë specifikimet standarde të FAO-s për shënjimin dhe identifikimin e anijeve të peshkimit.

7. Çdo palë do të sigurojë që çdo anije peshkimi, që mban flamurin e saj, ta furnizojë atë me informacionin e nevojshëm mbi veprimtarinë e saj me qëllim që t'i mundësojë palës plotësimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë në veçanti informacionin në lidhje me zonën e veprimtarisë së saj të peshkimit dhe me zëniet dhe zbarkimet e produkteve të saj.

8. Çdo palë do të marrë masa shtrënguese kundrejt anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e saj, të cilat veprojnë në kundërshtim me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, atëherë kur shihet e arsyeshme, vendosjen e gjobave për shkeljen e këtyre kërkesave në legjislacionin kombëtar. Sanksionet e zbatuara kundrejt këtyre shkeljeve duhet të jenë mjaftueshmërisht të rënda për të qenë efektive dhe që të sigurojnë plotësimin e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe t'i heqin shkelësve të ardhurat e përfitura nga aktiviteti i tyre i paligjshëm. Këto sanksione për shkelje të rënda, përfshijnë refuzimin, pezullimin ose heqjen e autorizimit të peshkimit në det të hapur.

Neni 4

Regjistrat e anijeve të peshkimit

Çdo palë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të mbajë një regjistër për anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e saj dhe të autorizuar për t'u përdorur për peshkim në det të hapur, dhe do të marrë masa të tilla, nëse mund të jenë të nevojshme, për të siguruar që të gjitha anijet e peshkimit të jenë të regjistruara në këtë regjistër.

Neni 5

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të përshtatshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë, do të shkëmbejnë informacion, duke përfshirë materiale evidencuese, në lidhje me aktivitetin e anijeve të peshkimit me qëllim që të ndihmojnë shtetin flamurbajtës në identifikimin e këtyre anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e saj të raportuara në aktivitete që dëmtojnë ruajtjen ndërkombëtare të burimeve dhe masat menaxhuese, me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 3.

2. Kur një anije peshkimi gjendet vullnetarisht në një port të një pale, të ndryshme nga ai i shtetit flamur, dhe Pala atëherë kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar që ajo anije peshkimi është përdorur në një aktivitet që dëmton efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese, do të njoftojë menjëherë për këtë shtetin flamurbajtës. Palët mund të ndërmarrin veprime në përputhje me detyrimet e shteteve portuale për masat hetimore në qoftë se ato do të konsiderohen të domosdoshme për të përcaktuar nëse ajo anije peshkimi është përdorur në kundërshtim me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët, atëherë kur është e nevojshme dhe në mënyrë të drejtë, do të hyjnë në marrëveshje bashkëpunimi ose mirëkuptimi të asistencës së përbashkët mbi baza globale, rajonale, nënrajonale ose dypalëshe, me qëllim nxitjen e përmbushjes së objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

1. Çdo Palë do të bëjë të disponueshëm vullnetarisht në FAO informacionin e mëposhtëm për çdo anije peshkimi të regjistruar në regjistrin e kërkuar nga neni 4:

a) emrin e anijes së peshkimit, numrin e regjistrit, emrat e mëparshëm (nëse njihen), dhe portin e regjistrimit;

b) flamurin e mëparshëm (në qoftë se ka);

c) sinjalin e radio-thirrjes ndërkombëtare (në qoftë se ka);

d) emrin dhe adresën e pronarit ose pronarëve;

e) kur dhe ku është prodhuar;

f) llojin e anijes;

g) gjatësinë.

2. Çdo palë, sa të jetë e mundur, do të bëjë të disponueshëm në FAO informacionin e mëposhtëm shtesë kundrejt çdo anijeje të regjistruar në regjistrin e kërkuar nga neni 4:

a) emrin dhe adresën e operatorit (menaxherit) ose operatorëve (menaxherëve) (në rast se ka);

b) llojin e metodës ose metodave të gjuetisë;

c) llojin e zhytjes;

d) gjerësinë maksimale;

e) tonazhin Lord të regjistruar (GRT);

f) fuqinë e motorit ose motorëve kryesorë.

3. Çdo Palë do të njoftojë menjëherë në FAO çdo modifikim të informacionit të renditur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

4. FAO do të qarkullojë periodikisht informacionin e marrë sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni te të gjitha palët dhe, sipas kërkesës, individualisht te secila palë. FAO, gjithashtu, në përputhje me kufizimet e

vendosura nga pala e interesuar në lidhje me shpërndarjen e informacionit, do të japë këtë informacion pas kërkesës individuale të çdo organizate peshkimi globale, rajonale, ose nënrajonale.

5. Çdo Palë gjithashtu do të informojë menjëherë FAO-n mbi:

a) çdo shtesë në regjistër;

b) çdo fshirje nga regjistri dhe arsyen për:

i) heqjen dorë ose mosrinovimin vullnetarisht të autorizimit të peshkimit nga pronari ose operatori i anijes së peshkimit;

ii) heqjen e autorizimit të peshkimit të lëshuar ndaj një anijeje peshkimi sipas paragrafit 8 të nenit 3;

iii) faktin që anija e peshkimit në fjalë nuk mban më flamurin e saj;

iv) dërgimin nëpër skrap, daljen jashtë përdorimit ose humbjen e anijes së peshkimit në fjalë; ose

v) çdo arsye tjetër.

6. Kur informacioni i jepet FAO-s sipas paragrafit 5(b) të mësipërm, pala e interesuar do të specifikojë cilat nga arsyet e renditura në këtë paragraf janë të zbatueshme.

7. Çdo palë do të informojë FAO-n mbi:

a) çdo përjashtim që ajo ka vendosur sipas paragrafit 2 të nenit 2, numrin dhe llojin e anijeve të peshkimit të përfshira dhe zonat gjeografike në të cilat këto anije peshkimi veprojnë; dhe

b) çdo marrëveshje të arritur sipas paragrafit 3 të nenit 2.

8. a) Çdo palë do të dërgojë menjëherë në FAO të gjitha informacionet e rëndësishme në lidhje me çdo anije peshkimi që mban flamurin e saj dhe që dëmton efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese, duke përfshirë dhe identitetin e anijes ose anijeve të peshkimit të përfshira dhe masat e marra nga ana e palës në respektimin e këtyre aktiviteteve. Raportet mbi masat e marra nga ana e palës mund të jenë objekt i disa kufizimeve sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar për të respektuar konfidencialitetin, duke përfshirë, në mënyrë të veçantë, konfidencialitetin për masat që janë marrë dhe që nuk janë akoma përfundimtare.

b) Çdo palë, atëherë kur ka dyshime të arsyetuar të besojë që një anije peshkimi që nuk mban flamurin e saj është e përfshirë në një aktivitet që dëmton efektshmërinë e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese, do t'ia paraqesë këtë shtetit flamurbajtës të interesuar dhe nëse është e arsyeshme, t'ia paraqesë FAO-s. Ajo do t'i japë shtetit flamurbajtës të gjitha evidentimet e mbështetura dhe mund t'i japë FAO-s një përmbledhje të këtyre evidentimeve. FAO nuk do të qarkullojë këtë informacion deri në atë kohë që shteti flamurbajtës ka mundësinë të komentojë në bazë të dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura, ose të kundërshtojë në rast se mund ta bëjë.

9. Çdo Palë do të informojë FAO-n për çdo rast kur një Palë, sipas paragrafit 5(d) të nenit 3, ka dhënë një autorizim pa marrë parasysh kërkesat e paragrafit 5(a) ose 5(b) të nenit 3, informacioni do të përfshijë të dhëna të padiskutueshme që lejojnë identifikimin e anijes së peshkimit dhe pronarin dhe operatorin dhe, nëse është e mundur, çdo informacion në lidhje me vendimin e palës.

10. FAO do të qarkullojë menjëherë informacionin e marrë sipas paragrafëve 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni te të gjitha Palët dhe, në bazë të kërkesës, individualisht te secila palë. FAO gjithashtu, duke zbatuar çdo kufizim të vendosur nga pala e interesuar në lidhje me shpërndarjen e informacionit, do të japë këtë informacion menjëherë sipas kërkesës individuale të çdo organizate peshkimi globale, rajonale ose nënrajonale.

11. Palët do të shkëmbejnë informacionin në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë edhe nëpërmjet FAO-s dhe organizatave të duhura të tjera të peshkimit në nivel global, rajonal dhe nënrajonal.

Neni 7

Bashkëpunimi me vendet në zhvillim

Palët do të bashkëpunojnë në nivel global, rajonal dhe nënrajonal ose dypalësh dhe, siç është e përshtatshme, me mbështetjen e FAO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ose rajonale, për të dhënë asistencë, duke përfshirë asistencën teknike, palëve që janë vende në zhvillim, me qëllim që t'i mbështesë ato në plotësimin e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Jopalët

1. Palët do të inkurajojnë çdo shtet jopalë të kësaj Marrëveshjeje të pranojnë këtë Marrëveshje dhe do të inkurajojnë çdo jopalë të aprovojë ligje dhe rregullore që kanë të bëjnë me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë konsistente me këtë Marrëveshje dhe me ligjin ndërkombëtar, me qëllim që anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e jopalëve të mos përfshihen në aktivitete që dëmtojnë efektshmërinë e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese.

3. Palët do të shkëmbejnë informacion midis tyre qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe

nëpërmjet FAO-s, kundrejt aktiviteteve që anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e jopalëve të mos dëmtojnë efektivitetin e ruajtjes ndërkombëtare të burimeve dhe masave menaxhuese.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Secila palë mund të kërkojë konsultime me çdo palë tjetër ose palët mbi çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose aplikimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje, me qëllimin për të arritur në një zgjidhje të ndërsjellë, të kënaqshme, sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen nëpërmjet konsultimeve në një kohë të arsyeshme, palët e mësipërme do të konsultohen midis tyre sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet negociatave, hetimit, ndërmjetësisë, pajtimit, arbitrit, zgjidhjes ligjore ose mjeteve të tjera paqësore në dispozicion të tyre.

3. Çdo mosmarrëveshje e këtij karakteri e pazgjidhur në këtë mënyrë, me pëlqimin e të gjitha palëve në mosmarrëveshje, do t'i referohet për zgjidhje vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Gjykatës Ndërkombëtare për Ligjin e Detit, që ka hyrë në fuqi me Konventën e Kombeve të Bashkuara me ligjin e detit të 1982 ose nëpërmjet arbitrit. Në rast të dështimit të arritjes së një marrëveshjeje bazuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në Gjykatën Ndërkombëtare të Ligjit të Detit ose arbitrit, palët do të vazhdojnë të konsultohen dhe të bashkëpunojnë me qëllim arritjen e një zgjidhjeje për mosmarrëveshjen në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar që lidhen me ruajtjen e burimeve detare të gjalla.

Neni 10

Pranimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për pranim nga secili anëtar ose anëtar i asociuar i FAO-s, dhe çdo shteti joanëtar që është anëtar i Kombeve të Bashkuara ose çdo agjencie të specializuar të Kombeve të Bashkuara ose Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.

2. Pranimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet i vlefshëm nëpërmjet depozitimit të instrumentit të pranimi të Drejtorit i Përgjithshëm i FAO-s që më poshtë do të referohet si Drejtori i Përgjithshëm.

3. Drejtori i Përgjithshëm do të informojë të gjitha palët, të gjithë anëtarët dhe anëtarët e asociuar të FAO-s dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të gjitha instrumentet e pranimi të marra.

4. Kur një organizatë integrimi ekonomik rajonal bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje, si organizatë integrimi ekonomik rajonal, në përputhje me klauzolat e nenit II.7 të Kushtetutës së FAO-s, në mënyrë të përshtatshme, do të njoftojë këto modifikime ose sqarime të deklaratës së saj të kompetencave të paraqitura sipas nenit II.5 të Kushtetutës së FAO-s siç mund të jetë e nevojshme, në dritën e pranimi të kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë e kësaj Marrëveshjeje, në çdo kohë mund t'i kërkojë organizatës së integritit ekonomik rajonal që është palë me këtë Marrëveshje që të japë informacion se cila, midis organizatës së integritit ekonomik rajonal dhe shteteve të saj anëtare, është përgjegjëse për zbatimin e çdo çështjeje të veçantë të parashikuar nga kjo Marrëveshje. Organizata e integritit ekonomik rajonal do të sigurojë këtë informacion në një kohë të arsyeshme.

Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes nga Drejtori i Përgjithshëm të instrumentit të njëzet e pestë të pranimi.

2. Për kuptimin e këtij neni, një instrument pranimi i depozituar nga një organizatë integrimi ekonomik rajonal nuk do të llogaritet shtesë me atë të depozituar nga shtetet anëtare të kësaj organizate.

Neni 12

Vërejtjet

Pranimi i kësaj Marrëveshjeje mund të jetë objekt i vërejtjeve, të cilat duhet të bëhen efektive vetëm pas pranimi unanim nga të gjitha palët e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë për këtë të gjitha palët për çdo vërejtje. Palët, të cilat nuk janë përgjigjur brenda tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit, do të konsiderohen që kanë pranuar vërejtjen. Mospranimi i kësaj vërejtjeje do të thotë që shteti ose organizata e integritit ekonomik rajonal nuk do të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Amendimet

1. Çdo propozim nga një palë për amendimin e kësaj Marrëveshjeje do të komunikohet te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Çdo amendament i propozuar për këtë Marrëveshje, marrë nga Drejtori i Përgjithshëm nga një palë do të paraqitet në një sesion të rregullt ose të jashtëzakonshëm të Konferencës për aprovim, në qoftë se amendimi përfshin ndryshime të rëndësishme teknike ose imponon detyrime shtesë për palët, ai duhet të shikohet nga një komitet specialistësh të thirrur nga FAO përpara Konferencës.

3. Njoftimi për çdo amendament të propozuar të kësaj Marrëveshjeje do t'u bëhet palëve nga Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se data kur do të shpërndahet axhenda e sesionit të Konferencës në të cilën kjo çështje do të merret në konsideratë.

4. Çdo amendament i tillë i propozuar i kësaj Marrëveshjeje do të marrë aprovimin e Konferencës dhe duhet të hyjë në fuqi nga dita e tridhjetë pas pranimi nga dy të tretat e palëve. Amendime që kërkojnë detyrime të reja për palët, në çdo rast, duhet të hyjnë në fuqi për të respektuar secilën palë vetëm me pranimin e tij dhe pas tridhjetë ditëve pas këtij pranimi. Çdo amendim do të konsiderojë futjen e detyrimeve të reja për palët, me përjashtim kur Konferenca me konsensus, në aprovimin e amendamentit të vendosë ndryshe.

5. Instrumenti i pranimi të amendamentit që parashikon futjen e detyrimeve të reja do të depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm, i cili do të informojë të gjitha palët mbi marrjen e pranimi dhe hyrjen në fuqi të amendimit.

6. Për kuptimin e këtij neni, një instrument pranimi i depozituar nga një organizatë integrimi ekonomik rajonal nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të kësaj organizate.

Neni 14 Tërheqja

Secila palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë pas kalimit të dy viteve nga data në të cilën kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në respektimin e secilës palë, nëpërmjet njoftimit me shkrim të kësaj tërheqjeje te Drejtori i Përgjithshëm, i cili do të informojë menjëherë të gjitha palët dhe anëtarët dhe anëtarët e asociuar të FAO-s për këtë tërheqje. Tërheqja do të bëhet efektive në fund të vitit kalendarik në vijim të atij në të cilin njoftimi i tërheqjes është marrë nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 15 Përgjegjësitë e depozituesit

Drejtori i Përgjithshëm do të jetë depozituesi i kësaj Marrëveshjeje. Depozituesi duhet:

a) të dërgojë kopje të vërtetuara të kësaj Marrëveshjeje secilit anëtar ose anëtar i asociuar i FAO-s dhe atyre shteteve joanëtare që mund të bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje;

b) të marrë masa për regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje, me hyrjen e saj në fuqi, me Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 102 të Marrëveshjes së Kombeve të Bashkuara;

c) të informojë çdo anëtar ose anëtar i asociuar të FAO-s, ose çdo shtet joanëtar që mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje të:

i) instrumenteve të pranimi të depozituara në përputhje me nenin 10;

ii) datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 11;

iii) propozimeve dhe amendamenteve të kësaj Marrëveshjeje dhe hyrjen e tyre në fuqi në përputhje me nenin 12;

iv) tërheqjes nga kjo Marrëveshje sipas nenit 14.

Neni 16 Autenticiteti i tekstit

Tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze dhe spanjolle të kësaj Marrëveshjeje janë autentikisht të barabartë.

LIGJ Nr.9402, datë 19.5.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SHITESË TË HUASË DHE TË PROJEKTIT, PËR MARRËVESHJEN E HUASË TË DATËS 24 KORRIK 1999, NDRYSHUAR ME MARRËVESHJEN SHITESË TË HUASË DHE TË PROJEKTIT TË DATËS 5 TETOR 2002, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (HUAMARRËSI) DHE

**KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT)
DHE KfW-SË (FRANKFURT AM MAIN) PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME ENERGJI
ELEKTRIKE PËR SHQIPËRINË JUGORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja shtesë e huasë dhe e projektit, për marrëveshjen e huasë të datës 24 korrik 1999, ndryshuar me marrëveshjen shtesë të huasë dhe të projektit të datës 5 tetor 2002, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW-së (Frankfurt am Main) për projektin “Furnizimi me energji elektrike për Shqipërinë Jugore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4609, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE SHITESË

E HUASË DHE PROJEKTIT, PËR MARRËVESHJEN E HUASË, TË DATËS 24 KORRIK 1999

(siç është ndryshuar nga Marrëveshja shtesë e huasë dhe projektit e datës 5 tetor 2002)

mes KfW Frankfurt am Main (“KfW”) dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga

Ministria e Financave

(“Huamarrësi”)

dhe

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (“Kesh”)

(“Agjencia Zbatuese e Projektit”)

për 13 289 521,59 euro

Furnizimi me energji elektrike për Shqipërinë Jugore

Në bazë të një marrëveshjeje për t’u lidhur, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, për bashkëpunimin financiar (“Marrëveshja qeveritare”), Huamarrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e huasë si vijon:

Seksioni 1

Modifikime të Marrëveshjes së huasë

1.1 Kushtet e mëposhtme të Marrëveshjes së huasë të datës 24 korrik 1999, për 35 000 000.00 DM (17 895 215.84 euro) siç janë ndryshuar nga Marrëveshja shtesë e huasë dhe projektit e datës 5 tetor 2002 për 2 556 459.41 euro, do të modifikohen si më poshtë vijon:

a) Neni 1.1

a) KfW do t’i ofrojë Huamarrësit një hua që nuk i kalon

33 741 196.84 euro

Në një porcion I prej

23 741 196.84 euro

Dhe një porcion II prej

10 000 000.00 euro

b) Neni 2

2.1 Huamarrësi do ta kalojë huanë tek Agjencia e Ekzekutimit të Projektit, në një Marrëveshje huaje të veçantë, sipas termave dhe kushteve të parashtruara në nenet 4.2, 4.5 dhe 4.6 më poshtë

c) Neni 3

3.1 KfW-ja do ta paguajë huanë si më poshtë:

a) Porcioni I i huasë do të paguhet në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesë të Agjencisë Zbatuese të Projektit.

b) Porcioni II i huasë do të paguhet në përputhje me furnizimin me mallra dhe kryerjen e shërbimeve për të cilat është rënë dakord në kontratat e eksportit.

3.2 Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e pagimit, në veçanti të dhënat që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar në këtë Marrëveshje.

3.3 Në rast se çmimet totale të mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga kjo hua, dhe të cilat janë miratuar në kontratat e eksportit, reduktohen gjatë periudhës së pagimit, KfW do të zvogëlojë përpjestimisht porcionet I dhe II. Nëse çmimi total i miratuar në kontratën e eksportit reduktohet dhe njëri prej porcioneve është paguar tërësisht, KfW mund të kryejë transfertat, me qëllimin për të rivendosur raportin fillestar ndërmjet porcioneve siç është parashtruar në nenin 1.1.

3.4 KfW do të ketë të drejtën të refuzojë kryerjen e pagesave pas 31 dhjetorit 2007. Megjithatë, në rast se ekzekutimi i kontratave të eksportit vonohet, KfW, me kërkesë të Huamarrësit, do të shqyrtojë, nëse dhe sipas të cilave kushte ky afat mund të shtyhet.

d) Neni 4

4.1 Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi prej 1/4% p.a. mbi shumat e papaguara të huasë. Tarifa e angazhimit do të përlogarit për një periudhë që nis në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe përfundon në datën kur debitohen pagesat.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interes për porcionin I të huasë, me një formë 0.75% p.a.

a) Huamarrësi do të paguajë interes për porcionin II me një normë që do të fiksohet nga KfW, brenda shtatë ditëve bankare, përpara çdo pagese të porcionit II, bazuar në kushtet ekzistuese për huatë afatgjata të tregut kapital, në Republikën Federale të Gjermanisë në atë kohë.

b) KfW do të kombinojë normat e interesit të fiksuar për çdo pagesë pasardhëse, pas pagesës së fundit të porcionit II për të formuar një normë të vetme interesi. Kjo normë e kombinuar interesi do të korrespondojë me mesataren e ponderuar të normave të veçanta të interesit - të rrumbullakosura në 1/10 000% nëse decimali i parë i fshirë është më pak se 5 ose afro 1/10 000% nëse decimali i parë i fshirë është i barbartë ose më i madh se 5 - dhe periudha, që nga data e secilës pagesë, deri në pagesën pasardhëse do të shërbejë si bazë për llogaritjen e interesit.

c) Norma e interesit e llogaritur pas pagesës së fundit do të shërbejë si bazë për llogaritjen e interesit, që nga data e pagesës së fundit deri në shlyerjen e plotë. KfW do të informojë Huamarrësin për mesataren e ponderuar të normës së interesit, të përcaktuar në këtë mënyrë. Kjo do të kryhet përmes një letre të regjistruar të dërguar me postë ajrore, e cila do të përmbajë planin e shlyerjes. Norma e interesit e komunikuar në këtë mënyrë do të bëhet e detyrueshme përmes konfirmimit përkatës.

Interesi do të kërkohej për periudhën që nga datat kur debitohen pagesat, deri në datat kur shlyerjet do të depozitohen në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.11.

4.3 a) Huamarrësi do të paguajë tarifën e angazhimit për huanë dhe interesin për porcionin I çdo gjashtë muaj, në 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për gjashtëmujorin që përfundon në atë datë.

b) Në vijim të nenit 3.6 Huamarrësi do të paguajë interesin e vendosur, përpara datës së caktuar të shlyerjes së kështit të parë të porcionit II, çdo gjashtë muaj në 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për gjashtëmujorin që përfundon në atë datë. Kur shlyerja e kështit të parë do të duhet të paguhet, sipas nenit 4.5, interesi do të ketë gjithashtu datën për t'u paguar së bashku me shlyerjen e këtij kështi, dhe do të ketë kohën për t'u paguar në fund të çdo gjashtëmujori, në datat pasardhëse të pagesës, të specifikuar në nenin 4.6.

4.4 Huamarrësi do të paguajë porcionin I të huasë si më poshtë vijon:

KËSTI	DATA	SHUMA
1	30 dhjetor 2009	292 970.00 euro
2	30 qershor 2010	292 970.00 euro
3	30 dhjetor 2010	292 970.00 euro
4	30 qershor 2011	292 970.00 euro

5	30 dhjetor 2011	292 970.00 euro
6	30 qershor 2012	335 400.00 euro
7	30 dhjetor 2012	335 400.00 euro
8	30 qershor 2013	335 400.00 euro
9	30 dhjetor 2013	335 400.00 euro
10	30 qershor 2014	335 400.00 euro
11	30 dhjetor 2014	335 400.00 euro
12	30 qershor 2015	389 400.00 euro
13	30 dhjetor 2015	389 400.00 euro
14	30 qershor 2016	389 400.00 euro
15	30 dhjetor 2016	389 400.00 euro
16	30 qershor 2017	389 400.00 euro
17	30 dhjetor 2017	389 400.00 euro
18	30 qershor 2018	389 400.00 euro
19	30 dhjetor 2018	389 400.00 euro
20	30 qershor 2019	389 400.00 euro
21	30 dhjetor 2019	389 400.00 euro
22	30 qershor 2020	389 400.00 euro
23	30 dhjetor 2020	390 920.00 euro
24	30 qershor 2021	390 920.00 euro
25	30 dhjetor 2021	390 920.00 euro
26	30 qershor 2022	390 920.00 euro
27	30 dhjetor 2022	390 920.00 euro
28	30 qershor 2023	390 920.00 euro
29	30 dhjetor 2023	390 920.00 euro
30	30 qershor 2024	390 920.00 euro
31	30 dhjetor 2024	390 920.00 euro
32	30 qershor 2025	390 920.00 euro
33	30 dhjetor 2025	390 920.00 euro
34	30 Qershor 2026	390 920.00 euro
35	30 dhjetor 2026	390 920.00 euro
36	30 qershor 2027	390 920.00 euro
37	30 dhjetor 2027	390 920.00 euro
38	30 qershor 2028	390 920.00 euro
39	30 dhjetor 2028	390 920.00 euro
40	30 qershor 2029	390 920.00 euro
41	30 dhjetor 2029	390 920.00 euro
42	30 qershor 2030	390 920.00 euro
43	30 dhjetor 2030	390 920.00 euro
44	30 qershor 2031	390 920.00 euro
45	30 dhjetor 2031	390 920.00 euro
46	30 qershor 2032	391 430.00 euro
47	30 dhjetor 2032	391 430.00 euro
48	30 qershor 2033	391 430.00 euro
49	30 dhjetor 2033	391 430.00 euro
50	30 qershor 2034	391 430.00 euro
51	30 dhjetor 2034	391 430.00 euro
52	30 qershor 2035	391 430.00 euro
53	30 dhjetor 2035	391 430.00 euro
54	30 qershor 2036	391 430.00 euro
55	30 dhjetor 2036	391 430.00 euro
56	30 qershor 2037	391 430.00 euro
57	30 dhjetor 2037	391 430.00 euro
58	30 qershor 2038	391 430.00 euro
59	30 dhjetor 2038	391 430.00 euro
60	30 qershor 2039	391 430.00 euro
61	30 dhjetor 2039	391 430.00 euro

62	30 qershor 2040	97 960.00 euro
63	30 dhjetor 2040	97 960.00 euro
64	30 qershor 2041	97 945.25 euro
65	30 dhjetor 2041	55 000.00 euro
66	30 qershor 2042	55 000.00 euro
67	30 dhjetor 2042	55 000.00 euro
68	30 qershor 2043	55 000.00 euro
69	30 dhjetor 2043	55 000.00 euro
70	30 qershor 2044	55 000.00 euro
71	30 dhjetor 2044	55 521.59 euro
	Shuma	23 741 196.84

4.5 Huamarrësi do të shlyejë porcionin II të huasë në 17 këste të barabarta, të njëpasnjëshme gjashtëmujore, i pari prej të cilëve do të paguhet gjashtë muaj pas datës së hyrjes në veprim të projektit, por jo më vonë se 31 dhjetori 2007. Provat që vërtetojnë gatishmërinë e hyrjes në veprim të projektit do të sigurohen përmes një konfirmimi të bërë konform shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. Sapo të jetë vendosur plani i shlyerjes, KfW do t'ia dërgojë atë Huamarrësit me postë ajrore, përmes një letre të regjistruar. Në këtë mënyrë, plani i shlyerjes do të jetë një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje huaje.

4.6 Nëse këstet e shlyera nuk janë në dispozicion të KfW-së në datën e pagesës, KfW do të ketë të drejtën të rrisë normën e interesit për detyrimet e pashlyera në normën bazë, plus 3% p.a. për periudhën që fillon në datën e pagesës dhe përfundon në datën në të cilën shlyerjet depozitohen në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.12. "Norma bazë" është norma e intesitetit e publikuar nga Deutsche Bundesbank si norma bazë për normën e aplikueshme në datën e pagesës. Për shlyerjen e kësteve që u ka kaluar afati të porcionit II, KfW do të ketë të drejtën të rrisë normën e interesit me 3% p.a. Interesi për shlyerjen e kësteve që u ka kaluar afati do të paguhet pa asnjë vonesë, që në kërkesën e parë të KfW-së.

4.7 KfW mund t'i kërkojë Huamarrësit të paguajë dëmet për pagesat e interesit që u ka kaluar afati ose pagesat e vonuara të tarifës së angazhimit në një shumë të vetme prej 3% mbi normën bazë, e cila është në fuqi në datën e pagesës. Një shumë e tillë do të përlllogaritet për periudhën që nga data e caktuar e pagesës, deri në datën kur pagesa e interesit ose pagesa e angazhimit depozitohen në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.12 dhe do të paguhet pa asnjë vonesë që në kërkesën e parë të KfW-së.

4.8 Tarifa e angazhimit, pagesa e interesit dhe pagesa të tjera shtesë për detyrime të pashlyera, në vijim të neneve 4.7 dhe 4.8 do të përlllogariten në bazë të një viti 360-ditor dhe muajve 30-ditorë.

4.9 Shumat e papaguara ose të shlyera para kohe të porcionit I do të depozitohen në proporcione të barabarta, pas shlyerjes së të gjitha kësteve të papaguara të porcionit të dhënë, përsa kohë që KfW, me dëshirën e vet, nuk vendos një mënyrë tjetër kompensimi në një rast të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave më të vogla. Shumat e papaguara ose të shlyera para kohe të porcionit II do të depozitohen pas shlyerjes së kësteve të fundit të porcionit II, në përputhje me planin e shlyerjes, përsa kohë që nuk miratohet një mënyrë tjetër kompensimi në një rast të veçantë.

4.10 KfW do të ketë të drejtën të depozitojë, me vullnetin e vet, pagesat e marra pas kryerjes së pagesave nën këtë Marrëveshje ose nën marrëveshje të tjera huaje të përfunduara ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.11 Huamarrësi do të ridërgojë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së nr.31 3954 7450 tek KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00.BIC KFWIDEFF, me referencë (Ref.viti/muaji/data), ndërkohë që nuk lejohet asnjë nisje kundërkërkesë ndaj këtyre pagesave. Detyrimi për kryerjen e pagesave të Huamarrësit do të përfundojë vetëm në rast se dhe në atë masë sa është kredituar llogaria e përcaktuar në monedhën e RFGJ-së, shumë e cila është e lirë për t'u përdorur sipas dëshirës së KfW-së.

e) Neni 5

5.1 Huamarrësi mund:

a) të heqë dorë nga disbursimi i shumave të huasë të porcionit I, në rast se ka përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 9;

b) të heqë dorë nga disbursimi i shumave të huasë të porcionit II në rast se KfW është dakord për këtë.

5.2 Huamarrësi mundet, me një njoftim paraparok 30 ditore, të ripaguajë porcionin II në mënyrë të përsheptuar vetëm nëse pagesa që do të kryejë përfshin një ose më shumë këste, së bashku me kompensimin për këto pagesa të përsheptuara që do të llogaritet nga KfW-ja mbi bazën e situatës së tregut të kapitaleve në atë moment duke marrë parasysh fitimet e humbura prej interesit dhe mundësitë e riinvestimit për periudhën e mbetur të afatit të huasë. Pas ripagimit të porcionit II, Huamarrësi mund të ripaguajë, plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të përsheptuar edhe porcionin I.

5.3 KfW mund të mos i pezullojë disbursimet duke përjashtuar rastet kur:

a) Huamarrësi nuk arrin të kryejë detyrimet e pagesave ndaj KfW në kohën e duhur:

b) Nuk respektohen detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje;

c) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk është në gjendje të provojë që burimet e huasë janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) Dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, vënien në punë ose qëllimin e projektit apo kryerjen e detyrimeve të pagesave, të pranuar nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.4 Nëse ka ndodhur ndonjë prej rasteve të specifikuar në nenin 5.3 a, b, ose c dhe ato nuk janë eliminuar brenda një periudhe të specifikuar nga KfW, e cila, gjithsesi, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW mund:

a) Të kërkojë, në rastet e specifikuar në nenin 5.3 a, ose nenin b, shlyerjen e menjëhershme të shumave të papaguara të huasë, si dhe shlyerjen e të gjithë interesit të shtuar si dhe pagesa të tjera të rastit.

b) Të kërkojë, në rastin e specifikuar në nenin 5.3 c, shlyerjen e menjëhershme të shumave të huasë për të cilat Agjencia Zbatuese e Projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

f) Neni 6

6.3 Përpara pagesës së parë të huasë, Huamarrësi do t'i sigurojë KfW-së të dhëna që provojnë se KfW është e përjashtuar nga të gjitha taksat mbi interesin dhe fitimet e tarifës së angazhimit në Shqipëri, me akordimin e huasë.

g) Neni 9

9.1 Huamarrësi do të sigurojë që personat e ngarkuar nga ai vetë për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, kontraktimin për mallrat dhe shërbimet që do të financohen, shpenzimet e kërkuara të shumave të huasë, nuk kërkojnë, pranojnë, shpërblejnë, dhurojnë, premtojmë ose marrin pagesa të paligjishme ose avantazhe të tjera, në lidhje me këto detyra.

9.2 Nëse ndonjë prej kushteve të kësaj Marrëveshjeje zhvlerësohet, të gjithë kushtet e tjera do të mbeten të paprekura. Çdo vakum që do të rezultojë nga kjo do të plotësohet nga një kusht i pajtueshëm me këtë Marrëveshje.

9.3 Kjo Marrëveshje huaje është ligjërish e pavarur nga kontratat e eksportit. Huamarrësi nuk duhet që, gjatë kryerjes së detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje huaje, të parashtojë justifikime që dalin nga kontrata e eksportit.

9.4 Huamarrësi dhe kompania zbatuese e projektit nuk mund të japin ose transferojnë, garantojnë ose lënë peng ndonjë pohim të kësaj Marrëveshjeje.

9.5 Kjo Marrëveshje do të kontrollohet nga ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i ekzekutimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.6 Kjo Marrëveshje huaje nuk do të hyjë në fuqi, për sa kohë që Marrëveshja qeveritare mbi të cilën bazohet nuk hyn në fuqi.

h) Neni 10

Garancia e Republikës Federale të Gjermanisë

KfW do të ketë kërkesa, që dalin nga porcioni II, garantuar nga Republika Federale e Gjermanisë, përpara pagimit të porcionit II. Hyrja në fuqi, pa asnjë kufizim e kësaj garancie do të jetë një kusht i domosdoshëm për pagimin e porcionit II.

1.2 Të gjitha kushtet e tjera të Marrëveshjes së huasë dhe projektit të datës 24 korrik 1999, siç janë ndryshuar nga Marrëveshja shtesë e huasë dhe projektit, e datës 5 tetor 2002 do të mbeten të pandryshuara.

Kushte plotësuese

2.1 Pagesa e angazhimit për shumën plotësuese të huasë prej 13 289 521.59 euro do të përlogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje shtesë të huasë dhe përfundon në datat kur do të debitohen pagesat.

2.2 Në periudhën përpara pagesës së parë, nga shuma shtesë e huasë, Huamarrësi do t'i sigurojë KfW-së prova të kënaqshme për KfW-në, që vërtetojnë se Huamarrësi i ka përmbushur të gjitha kërkesat, sipas ligjeve të veta kushtetuese dhe ligjeve të tjera që bëjnë të vlefshme pranimin e të gjitha detyrimeve të Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Kjo Marrëveshje shtesë e huasë dhe projektit nuk do të hyjë në fuqi derisa të hyjë në fuqi Marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo është bazuar.

Bërë në tre origjinalë në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main

Tiranë

11.1.2005

DISPOZITË ARBITRAZHI

Të gjitha mosmarrëveshjet e dala nga marrëveshja paraprirëse dhe të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes paraprirëse që nuk do të mund të zgjidhen me mirëkuptim nga Palët Kontraktuese, do të paraqiten për veprime gjyqësore siç është rënë dakord në Marrëveshjen gjyqësore bashkëlidhur Marrëveshjes së huasë dhe projektit të datës 24 korrik 1999 - Furnizimi me energji, Shqipëria Jugore. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje gjyqësore do të zgjatet deri në përmbushjen e plotë të të gjitha detyrimeve të pagesave, sipas marrëveshjes paraprirëse.

LIGJ

Nr.9403, datë 19.5.2005

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI, PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet “Konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, nënshkruar në Tiranë më 22.12.2004.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4610, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTË

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Serbisë dhe Malit të Zi, duke dëshiruar të përfundojnë një Konventë për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Personat që mbulon Konventa

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese
Neni 2

Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, të zbatuara në emër të një Shteti Kontraktues ose nga nënndarjet e tij politike apo autoritetet lokale pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Konventa, janë në veçanti:

në Serbi dhe Mal të Zi:

1) tatimi mbi fitimin;

2) tatimi mbi të ardhurat;

3) tatimi mbi kapitalin;

4) tatimi mbi të ardhurat nga transporti ndërkombëtar;

(në vijim do t'u referohemi si "Tatimet serbe dhe malazeze").

në Shqipëri:

1) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

2) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

3) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "Tatimet shqiptare").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëlllojta ose tepër të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Konventës si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që do të bëhet në ligjet e tyre tatimore.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente:

1) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Serbinë dhe Malin e Zi, siç e kërkon përmbajtja;

2) termi "Serbia dhe Mali i Zi" nënkupton komunitetin shtetëror Serbia dhe Mali i Zi, dhe kur përdoret në sensin gjeografik nënkupton territorin tokësor të Serbisë dhe të Malit të Zi, ujërat e saj detare të brendshme dhe ujërave territoriale detare, hapësirën ajrore mbi to, si edhe tabanin detar dhe nëntokën përtej ujërave territoriale, mbi të cilat Serbia dhe Mali i Zi ushtron të drejtën e saj sovranë, për qëllim eksplorimi e shfrytëzimi të burimeve natyrore, në përputhje me ligjin e brendshëm dhe të drejtën ndërkombëtare;

3) termi "Shqipëri" nënkupton Republikën e Shqipërisë, dhe kur përdoret në sensin gjeografik nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

4) termi "nënndarja politike", në komunitetin shtetëror Serbia dhe Mali i Zi, nënkupton shtetet anëtare;

5) termi "nënshtetas" nënkupton:

- çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

- çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzojnë statusin si të tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

6) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

7) termi "shoqëri" nënkupton një person juridik ose çdo ent që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

8) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

9) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, avion ose mjet hekurudhor apo rrugor që kryhet nga një sipërmarrje që ka qendrën efektive të drejtimit në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija,

avioni ose mjeti hekurudhor apo rrugor vepron vetëm brendapërbrenda Shtetit tjetër Kontraktues;

10) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

- në Serbinë dhe Malin e Zi, Ministrinë për Çështjet Ekonomike Ndërkombëtare ose përfaqësuesin e autorizuar prej saj;

- në Shqipëri, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Për sa i përket zbatimit të kësaj Konvente nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet e të cilit zbatohet Konventa; çdo kuptim sipas legjislacionit tatimor të atij shteti ka përparësi ndaj kuptimit të dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person, i cili, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritete lokale atje. Por, sidoqoftë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhura nga burime në atë shtet apo kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

1) ai do të konsiderohet rezident i shtetit, në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

2) në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ai qëndron zakonisht;

3) në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i shtetit nënshtetas i të cilit ai është;

4) në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person joindivid është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin është vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

Neni 5 Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, tërësisht ose pjesërisht, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

1) një vend drejtimi;

2) një degë;

3) një zyrë;

4) një fabrikë;

5) një punishte; dhe

6) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” do të përfshijë gjithashtu:

1) një shesh ndërtimi, një konstruksion, projekt montimi apo instalimi ose aktivitete mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur një shesh i tillë, projekt apo aktivitet vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj, brenda çdo periudhe 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal;

2) furnizimi i shërbimeve, përfshirë shërbimet konsultative, nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo edhe personelit tjetër të zënë në punë nga sipërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet e kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë nëntë muaj brenda çdo periudhe 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

- 1) përdorimin i pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje rastësore të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;
- 2) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje rastësore;
- 3) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;
- 4) mbajtja e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

5) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

6) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në paragrafin 1) deri 5), me kusht që aktiviteti në përgjithësi i vendit fiks të biznesit që rezulton nga një kombinim i tillë është i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6 vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ky person ndërmerr për sipërmarrjen, përveç kur personi:

- 1) ka dhe zakonisht ushtron shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi; ose

- 2) nuk ka një autoritet të tillë, por zakonisht mban në shtetin e përmendur në fillim një gjendje mallrash nga ku ai shpërndan rregullisht mallra në emër të sipërmarrjes.

6. Një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznesin në këtë shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm, agjenti apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar njërin kompani seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuri të paluajtshme, (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufuktin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore anijet, avionët dhe mjetet hekurudhore apo rrugore nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet biznesore

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur

sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatonen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte, nëse ajo do të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtën aktivitet ose në aktivitete të ngjashme nën kondita të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimet e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e aktivitetit selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive, si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë. Megjithatë, nuk do të trajtohen si shpenzime të zbritshme ato shuma, nëse ka, të paguara, (përveç atyre për rimbursimin e shpenzimeve të kryera) të paguara nga një seli e përhershme për një zyrë qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose për komisione për shërbime të veçanta të kryera apo për menaxhim, ose përveç rastit të sipërmarrjeve bankare për interesa të huave dhënë selisë së përhershme. Në të njëjtën mënyrë nuk do të merren parasysh në përcaktimin e fitimeve të selisë së përhershme, ato shuma (përveç atyre për rimbursime të shpenzimeve të kryera), të paguara nga ana e selisë së përhershme për zyrën qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose për komisione për shërbime të veçanta të kryera apo për menaxhim, ose për veç rastit të sipërmarrjeve bankare, për interesa të huave dhënë selisë së përhershme ose ndonjë zyre tjetër të saj.

4. Përderisa zakonisht në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve që i atribuohen një selie të përhershme bëhet në bazë të ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet e tatueshme në bazë të kësaj metode ndarjeje siç veprohet zakonisht, megjithatë, metodat e ndarjes të përdorura duhet të jenë të tilla që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selije të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra për sipërmarrjen nëpërmjet kësaj selie të përhershme.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit, përderisa të mos ketë arsye të forta dhe të mjaftueshme për të proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elementë të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Trafiku ndërkombëtar

1. Fitimet, veprimtaria e anijeve, avionëve ose mjeteve hekurudhore apo rrugore në trafikun ndërkombëtar do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Fitimet nga veprimtaria e anijeve në transportin e brendshëm ujor do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv i sipërmarrjes.

3. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrjeje të transportit detar ose i një sipërmarrjeje të transportit të brendshëm ujor është në bordin e një anije, atëherë ndërmarrja do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet porti i vet i anijes, ose kur nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është operuesi i anijes.

4. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen, gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9

Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

1) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

2) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë vendosur ndërmjet dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që duhej të realizohej nga njëra sipërmarrje, por, për shkak të këtyre kushteve nuk

është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij Shteti- dhe i taton normalisht-fitimet mbi të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura ndërmjet dy sipërmarrjeve kanë qenë ato që do vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar në atë shtet mbi ato fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, do të respektohen edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevojë do të konsultohen me njëri tjetrin.

Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividendë mund të tatohen, gjithashtu në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

1) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga ortakëria), që zotëron direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë paguese të dividendëve;

2) 15 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do ketë efekt tatimin e shoqërisë për fitimet prej të cilave janë paguar dividendët.

3. Termi “dividendë” në përdorimin në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet apo të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet, nga ligjet e shtetit rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve duke qënë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 15, si të paraqitet rasti.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër; gjithashtu subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

Neni 11 Interesat

1. Interesat që realizohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen, gjithashtu edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i interesave është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim, dhe nëse kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet e çdo lloji, përfshirë edhe fitimet apo shpërblimet që rrjedhin nga këto bono apo obligacione. Gjohet e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave duke qënë një rezident i një Shtet Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e

lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 15, si të paraqitet rasti.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme apo baza fikse.

6. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në kërkesën e borxhit për të cilën ato paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të lidhjeve të tilla të veçanta, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit shtet, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12 Honoraret

1. Honoraret që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të taten, gjithashtu edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i honorareve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorareve. Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat ose kasetat e vidiokasetat për transmetime radio-televizive, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për përdorimin apo të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 15, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan këto honorare qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të këtyre honorareve dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lidhur në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla të veçanta, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13 Pagesat për shërbimet teknike

1. Pagesat për shërbimet teknike që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe paguhet nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto pagesa për shërbime teknike mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por në qoftë se pronari përfitues i pagesave për shërbimet teknike është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar në këtë rast nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të pagesës për shërbimet teknike. Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “pagesa për shërbime teknike”, sipas përdorimit në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji që i

bëhen një personi, të ndryshëm nga punëmarrësi i personit i cili bën pagesën, në lidhje në çdo lloj shërbimi teknik, menaxhimi apo natyre konsultative.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i pagesave për shërbimet teknike, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen pagesat për shërbimet teknike, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryhen në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty dhe pagesa për shërbime teknike është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 15, si të paraqitet rasti.

5. Pagesat për shërbimet teknike do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij shteti. Megjithatë kur personi që bën pagesat për shërbimet teknike, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme apo një bazë fikse lidhur me të cilën është detyrimi për të cilin është kryer pagesa, dhe këto pagesa për shërbime teknike kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto pagesa për shërbime teknike do të konsiderohen se kanë lindur në atë shtet ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur, për shkak të marrëdhënieve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shumica e pagesës për shërbimet teknike, e kalon shumën për të cilën do të bihej dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm ndaj shumës së përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohet në këtë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues me qëllim kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose bazës fikse, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve, avionëve ose i mjeteve hekurudhore apo rrugore që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, anijeve që veprojnë në transportin e brendshëm ujor ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, avionëve ose i mjeteve hekurudhore apo rrugore do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit të një shoqërie, pasuria e së cilës konsiston direkt ose indirekt kryesisht në pasuri të paluajtshme të vendosura në një Shtet Kontraktues mund të tatohen në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohen nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 15

Shërbimet personale të pavarura

1. Të adhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat që vijnë, kur këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

1) kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet kësaj baze fikse mund të tatohet në këtë shtet tjetër; ose

2) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të kryera në këtë shtet tjetër mund të tatohet në këtë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

Neni 16
Shërbimet personale të varura

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 17, 19, 20, 21 dhe 22 pagat, rogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij, do të tatohen vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura të nxjerra prej kësaj pune mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet që vijnë:

1) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

2) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

3) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e përfituara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje, avioni ose mjeti hekurudhor apo rrugor që operon në trafikun ndërkombëtar ose në bordin e një anijeje që operon në transportin e ujërave të brendshme, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

Neni 17
Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i këshillit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Neni 18
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 15 dhe 16, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radio-televizioni, si muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla, të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë që nuk realizohen direkt nga sportisti apo artisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 15 dhe 16, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga aktivitetet e tij personale si një sportist apo si një artist do të tatohen vetëm në këtë shtet nëse aktivitetet janë ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues në bazë të një marrëveshjeje për shkëmbime kulturore apo sportive miratuar nga të dy Shtetet Kontraktuese.

Neni 19
Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 20, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 20
Shërbimet qeveritare

1. 1) Rogat, pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues apo një nënndarje politike ose nga një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera e atij shteti, nënndarje politike ose autoriteti do të tatohen vetëm në atë shtet.

2) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti, i cili:

- është nënshkretar i atij shteti; ose

- nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. 1) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues apo nënndarje

politike ose një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, apo nënndarje ose autoriteti do të tatonen vetëm në atë shtet.

2) Megjithatë, këto pensione do të tatonen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është rezident dhe nënshetës i këtij shteti.

3. Dispozitat e neneve 16, 17, 18 dhe 19 do të zbatohen mbi rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensionet, lidhur me shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues apo nënndarje politike ose një autoritet lokal atje.

Neni 21

Studentët dhe specialistët

1. Kur një student apo specialist që është ose ishte menjëherë para ardhjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim të arsimimit ose specializimit të tij, për çdo pagesë të marrë për qëllim të mbajtjes së tij, arsimimi apo specializimit nuk do të tatonet në atë shtet, me kusht që këto pagesa të kryhen nga burime jashtë këtij shteti.

2. Përsa i përket dhurimeve, bursave dhe shpërblimeve nga punësimi, që nuk mbulohen nga paragrafi 1, një student ose specialist i përshkruar në paragrafin 1 merr si shtesë, këto të ardhura do t'i nënshtrohen, gjatë periudhës së arsimimi ose trajnimit, të njëjtave përjashtime, lehtësive apo reduktime tatimore si rezidentët e shtetit ku ata janë prezent.

Neni 22

Pedagogët dhe kërkuesit shkencorë

1. Një individ i cili viziton një Shtet Kontraktues, me qëllim mësimdhënien ose kryerjen e kërkimeve në një universitet, kolegji, shkollë apo institucion tjetër arsimor i njohur në këtë shtet dhe që është ose ishte menjëherë para kësaj vizite rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, shpërblimet që i jepen për këtë mësimdhënie apo kërkim, do të përjashtohen nga tatimet në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim për një periudhë që nuk i kalon dy vjet nga data e vizitës së tij të parë për këtë qëllim, me kusht që këto pagesa të kryhen nga burime jashtë këtij vendi.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave nga kërkimi nëse ky kërkim është ndërmarrë jo për interesat publike, por kryesisht për përfitime private të një personi apo personave të veçantë.

Neni 23

Të ardhura të tjera

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen artikujt e mëparshëm të kësaj Konvente do të tatonen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 15, si të paraqitet rasti.

Neni 24

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatonen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuri biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatonen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije, avionë apo mjete hekurudhore ose rrugore që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga anije që veprojnë në transportin e brendshëm ujor, si dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve, avionëve apo mjeteve hekurudhore ose rrugore do të tatonen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet.

Neni 25

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues, shteti i përmendur në fillim do të lejojë:

- një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në këtë shtet tjetër;
- një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin e paguar në këtë shtet tjetër.

Megjithatë, në secilin rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Kur në përputhje me dispozitat e Konventës të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohet nga tatimi në këtë shtet, megjithatë, në llogaritjen e shumës të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, ky shtet merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

3. Me qëllim të lejimit si një reduktim në një Shtet Kontraktues, tatimi i paguar në Shtetin tjetër Kontraktues do të konsiderohet se përfshin tatimin i cili duhej paguar në këtë shtet tjetër, por që është reduktuar apo përjashtuar nga ai shtet, në zbatim të legjislacionit të tij për lehtësitë tatimore.

Neni 26

Mosdiskriminimi

1. Nënshetaset e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen nënshetaset e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo të asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësi personale dhe reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11, paragrafit 6 të nenit 12 ose paragrafit 6 të nenit 13 interesat, honoraret, pagesat për shërbime teknike dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëjloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëjloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është tërësisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë tjetër ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

Neni 27

Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij Autoriteteve Kompetente të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është, ose nëse rasti lidhet me paragrafin 1 të nenit 26, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshetaset i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet

brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë lidhur me tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti Kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me Autoritetin Kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga kufijtë kohorë që mund të parashikojë legjislacioni i brendshëm i Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk parashikohet nga Konventa.

4. Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt, përfshirë dhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët të përbërë prej tyre apo përfaqësuesve të tyre, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 28

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese, lidhur me tatimet që mbulon Konventa, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën, në veçanti për parandalimin e evazionit apo mashtrimit për këto tatime. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjen lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

1) të zbatojnë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

2) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

3) të japë informacione që mund të nxirrin një sekret tregtar, biznesor, industrial, komercial ose profesional, apo informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendi publik).

Neni 29

Funksionarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 30

Hyrja në fuqi

1. Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se kërkesat e tyre ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente janë plotësuar.

2. Konventa do të hyjë në fuqi në datën e dorëzimit më të vonshëm të këtij njoftimi dhe dispozitat e saj do të kenë efekt lidhur me tatimin mbi të ardhurat e realizuara dhe tatimin mbi kapitalin e zotëruar në çdo vit fiskal që fillon më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin Konventa hyn në fuqi.

Neni 31

Përfundimi

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet

Kontraktues mund të përfundojë Konventën, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik, që fillon pas mbarimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt lidhur me tatimin mbi të ardhurat e realizuara ose tatimin mbi kapitalin e zotëruar në çdo vit fiskal që fillon më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruarit, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Tiranë, më 22.12.2004 në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe të dy origjinalet kanë vlera të barabarta. Në raste divergjencash në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

LIGJ

Nr.9404, datë 19.5.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN, PËR PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMET KOMUNITARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare”, nënshkruar në Bruksel më 22 nëntor 2004.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4611, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE KUADËR

**NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE SHQIPËRISË MBI PARIMET E PËRGJITHSHME PËR
PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMET KOMUNITARE**

Komuniteti Europian, këtu e tutje referuar si “Komuniteti”, nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, këtu e tutje referuar si “Shqipëria”, nga ana tjetër, të dyja palët këtu e tutje referuar si “Palët Kontraktuese”, duke marrë parasysh se:

1) Këshilli Europian në Kopenhagë në dhjetor 2002 konfirmoi perspektivën europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si kandidatë të mundshëm, dhe theksoi vendosmërinë e tij, për të mbështetur përpjekjet e tyre për t’iu afruar më shumë Bashkimit Europian;

2) Këshilli Europian në Selanik në qershor 2003 pranoi që procesi i Stabilizim-Asocimit do të mbetet kuadri për të gjithë rrugën europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt hyrjes së ardhshme dhe miratoi “Axhendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: rruga drejt integritetit europian”, e cila synon të përforcojë më tej marrëdhëniet e privileguara midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duke u mbështetur në përvojën e zgjerimit të BE-së;

3) Axhenda e Selanikut ftoi vendet e Ballkanit Perëndimor të merrnin pjesë në programet dhe agjencitë e komunitetit në përputhje me parimet e vendosura për pjesëmarrjen e vendeve candidate, duke synuar t’i njohë vendet në fjalë dhe popujt e tyre me politikat dhe metodat e punës së BE-së, duke i afruar kështu edhe më fort me BE-në dhe duke i nxitur në rrugën drejt integritetit europian;

4) Shqipëria ka shprehur dëshirën e saj të marrë pjesë në disa programe komunitare;

5) Rregullat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe kontributin përfundimtar, lidhur me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të posaçëm, duhet të përcaktohen me marrëveshje midis Komisionit të Komuniteteve Europiane, në emër të komunitetit dhe Qeverisë së Shqipërisë,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Shqipëria do të lejohet të marrë pjesë në këto programe komunitare:

a) Programet komunitare aktive, të cilat jepen në shtojcën I, të cilat janë të hapura ndaj pjesëmarrjes së Shqipërisë sapo të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje (këtu e tutje referuar si “Marrëveshja”).

b) Programet komunitare, të cilat krijohen ose ripërtërihen pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, dhe të cilat përmbajnë një dispozitë hyrëse që parashikon pjesëmarrjen e Shqipërisë.

Neni 2

Shqipëria do të kontribuojë nga ana financiare në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian sipas programeve të veçanta në të cilat merr pjesë.

Neni 3

Përfaqësuesit e Shqipërisë do të lejohen të marrin pjesë, si vëzhgues dhe për ato çështje të cilat kanë të bëjnë me Shqipërinë, në komitetet e menaxhimit të cilat janë përgjegjëse për monitorimin e programeve për të cilat Shqipëria kontribuon financiarisht.

Neni 4

Projektet dhe nismat që paraqiten nga pjesëmarrësit nga Shqipëria do t’u nënshtrohen, për aq sa është e mundur, të njëjtave kushte, rregullave dhe procedurave lidhur me programet në fjalë, që vlejnë edhe për shtetet anëtare.

Neni 5

Rregullat dhe kushtet specifike, lidhur me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin program të veçantë, e veçanërisht kontributi financiar që duhet paguar, do të përcaktohen me marrëveshje, në formën e një memorandumit mirëkuptimi, midis Komisionit, i cili vepron në emër të komunitetit, dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Në rast se Shqipëria aplikon për ndihmë të jashtme komunitare në bazë të Rregullores së Këshillit (CE) nr.2666/2000, të datës 5 dhjetor 2000, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit (CE) nr.2415, datë 10 dhjetor 2001 për ndihmën për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ose në përputhje me çdo rregullore të ngjashme që parashikon ndihmë të jashtme komunitare për Shqipërinë, e cila mund të miratohet në të ardhmen, kushtet që rregullojnë përdorimin nga Shqipëria të ndihmës komunitare do të përcaktohen në një marrëveshje financiare.

Neni 6

Memorandumi i mirëkuptimit do të përcaktojë, në përputhje me rregullat financiare të komunitetit, që kontrolli ose revizionimet financiare do të bëhen prej, ose nën autoritetin e Komisionit Europian, ZLKK-së dhe Gjykatës së Llogarive e Komuniteteve Europiane.

Dispozita të hollësishme do të përfshihen për kontrollin dhe revizionimin financiar, masat administrative, ndëshkimet dhe rekuperimin, duke aftësuar Komisionin Europian, ZLKK-në dhe Gjykatën e Llogarive të kenë fuqi të barasvlefshme me fuqitë e tyre, lidhur me fituesit ose kontraktuesit e vendosur në komunitet.

Neni 7

Marrëveshja do të zbatohet për një periudhë të papërcaktuar kohe.

Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar me shkrim Palën tjetër Kontraktuese. Kjo Marrëveshje do të bjerë nga fuqia gjashtë muaj pas datës së një njoftimi të tillë.

Neni 8

Jo më vonë se tre vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dhe çdo tre vjet më pas, të dyja Palët Kontraktuese mund të rishikojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në bazë të pjesëmarrjes konkrete të

Shqipërisë në një ose më shumë programe komunitare.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të vlejë, nga njëra anë, për ato territore në të cilat zbatohet Traktati Themelues i Komunitetit Europian dhe nën ato kushte që parashikon ky Traktat, dhe nga ana tjetër, për territorin e Shqipërisë.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me anë të të cilit secila Palë Kontraktuese informon tjetrën që procedurat e saj për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përfunduar.

Neni 11

1) Marrëveshja hartohet në dy kopje në gjuhët çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, frënge, gjermane, greke, hungareze, italiane, letoneze, lituaneze, polake, portugeze, sllovaqe, sllovene, spanjolle, suedeze si dhe shqip.

2) Kur institucionet e Bashkimit Europian do të detyrohen të botojnë të gjitha aktet zyrtare në gjuhën malteze në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, Marrëveshja do të hartohet në dy kopje edhe në gjuhën malteze.

3) Secili nga tekstet në secilën gjuhë është njësoj autentik.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për Komunitetin Europian
Por La Comunidad Europea
Za Evropské společenství
For Det Europæiske Fællesskab
Für die Europäische Gemeinschaft
Euroopa Ühenduse nimel
Για την Ευρωπαϊκή Κοινότητα
For the European Community
Pour la Communauté européenne
Per la Comunità europea
Eiropas Kopienas vārdā
Europos bendrijos vardu
az Európai Közösség részéről
Ghall-Komunità Ewropea
Voor de Europese Gemeenschap
W imieniu Wspólnoty Europejskiej
Pela Comunidade Europeia
Za Európske spoločenstvo
za Evropsko skupnost
Euroopan yhteisön puolesta
På Europeiska gemenskapens vägnar

SHTOJCA I

LISTA E PROGRAMEVE KOMUNITARE AKTIVE, REFERUAR NË NENIN 1

- Lufta kundër diskriminimit (2001-2006)¹
- Lufta kundër përjashtimit shoqëror (2001-2006)²
- Masat komunitare në mbështetje të politikës së konsumatorit (2004-2007)³
- Programi komunitar i veprimit për të ndihmuar organizatat që veprojnë në planin evropian dhe për të mbështetur veprimtari specifike në fushën e arsimit dhe trajnimit (2004-2006)⁴
- Programi komunitar i veprimit për nxitjen e qytetarisë aktive evropiane (2004- 2006)⁵
- Veprimi komunitar në fushën e shëndetit publik (2003-2008)⁶
- Kultura 2000 (2000-2006)⁷
- Doganat (2003-2007)⁸
- Programi Daphne II (2004-2008)⁹
- eContent Plus (2004-2008)¹⁰
- eLearning (2004-2006)¹¹
- Erasmus Mundus (2004-2008)¹²
- Programi Fiscalis (2003-2007)¹³
- Barazia gjinore (2001-2006)]¹⁴
- Programi Hercule (2004-2006)¹⁵

¹ Krah. Vendimi i Këshillit nr. 2000/750 /EC i datës 27 nëntor 2000 që krijoi një program veprimi komunitar për të luftuar kundër diskriminimit (2001 deri 2006) - OJL 303/2000

² Krah. Vendimi nr.50/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të datës 7 dhjetor 2001 që krijoi një program veprimi komunitar për rritjen e bashkëpunimit midis shteteve anëtare për të luftuar kundër përjashtimit shoqëror - OJL 10/2002

³ Krah. Vendimi nr.20/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 8 dhjetor 2003 që krijoi një kuadër për financimin e veprimeve komunitare në mbështetje të politikës së konsumatorëve për vitet 2004 deri 2007 (Teksti me interes për AEM-në) -OJL 05/2004

⁴ Krah. Vendimi nr.791/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 21 prill 2004 që krijoi një program veprimi komunitar për të ndihmuar organizatat që veprojnë në planin evropian dhe për të mbështetur veprimtari specifike në fushën e arsimit dhe trajnimit - OJL 138/2004

⁵ Krah. Vendimi i Këshillit nr.2004/100/EC i datës 26 janar 2004 që krijoi një program veprimi komunitar për të nxitur qytetarinë aktive evropiane (pjesëmarrjen civile - OJL 030/2004

⁶ Krah. Vendimi nr.1786/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 23 shtator 2002 që miratoi një program veprimesh komunitare në fushën e shëndetit publik (2003-2008) -OJL 271/2002

⁷ Krah. Vendimi nr. 508/2000/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 14 shkurt 2000 që krijoi programin Kultura 2000 - OJL 63/2000 dhe vendimi nr. 626/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 31 mars 2004 që ndryshoi vendimin nr.508/2000/EC që krijoi programin Kultura 2000 (Tekst me interes për AEM-në)-OJL 99/2004

⁸Krah. Vendimi nr. 253/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 11 shkurt 2003 që miratoi një program veprimesh për doganat në komunitet (Dogana 2007) - OJL 36/2003

⁹Krah. Vendimi nr. 803/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 21 prill 2004 që miratoi një program veprimesh komunitare (nga 2004 deri 2008) për të parandaluar dhe luftuar kundër dhunës kundër fëmijëve, të rinjve dhe grave dhe për t'i mbrojtur viktimat dhe grupet e rrezikuara (programi Daphne II) – OJL 143/2004

¹⁰pret miratimin — Krah. COM [2004] 96 — 2004/0025/COD

¹¹ Krah. Vendimi nr.2318/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 5 dhjetor 2003 që miratoi një program shumëvjeçar (nga 2004 deri 2006) për integrimin e efektshëm të teknologjive informatike dhe komunikimit (ICT) në sistemet arsimore dhe trajnuese në Europë (Programi eLearning) - OJL 345/2003

¹²Krah. Vendimi nr. 2317/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 5 dhjetor 2003 që krijoi një program për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, si dhe për rritjen e mirëkuptimit ndërkulturor nëpërmjet bashkëpunimit me vendet e treta (Erasmus Mundus) (nga 2004 deri 2008) — OJL 345/2003

¹³Krah. Vendimi nr. 2235/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 3 dhjetor 2002 që miratoi një program komunitar për përmirësimin e funksionimit të sistemeve tatimore në tregun e brendshëm (Programi Fiscalis 2003-2007) - OJL 341/2002

¹⁴Krah. Vendimi i Këshillit nr. 2001/51/EC i datës 20 dhjetor 2000 që krijoi një program lidhur me kuadrin strategjik komunitar për barazinë gjinore (2001-2005) - OJL 017/2001 me ndryshimet nga vendimi i Këshillit [...] OJL [...] [po përgatitet zgjatja deri në fund të vitit 2006-krah.COM(2004)551-2004/0194 COD]

¹⁵Krah. Vendimi nr.804/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të datës 21 prill 2004 që krijoi një program masash komunitare për të ndihmuar veprimtaritë në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të komunitetit (Hercule-programme) - OJL 143/2004

- Energji Inteligjente për Europën (2003-2006)¹⁶
- Life (2000-2006)¹⁷
- Leonardo da Vinçi II (2000-2006)¹⁸
- Programi Marko Polo (2003-2010)¹⁹
- Media Plus²⁰ / Trajnimi i medias (2001-2006)²¹
- Internet më i sigurt plus (2005-2008)²²
- Programi i gjashtë për zhvillimin dhe kërkimin teknologjik (2002-2006)²³
- Socrates II (2000-2006)²⁴
- Rinia (2000-2006)²⁵

VENDIM
Nr.441, datë 16.6.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMN NR.159, DATË 13.3.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURA E SHITJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

¹⁶Krah. Vendimi nr.1230/2003/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 26 qershor 2003 që miratoi një program shumëvjeçar për veprim në fushën e energjetikës: “Energji Inteligjente për Europën” (2003 - 2006) (Tekst me interes për AEM-në) - OJL 176/2003

¹⁷Krah. Rregullorja (EC) nr.1655/2000 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit i datës 17 korrik 2000 lidhur me Instrumentin Financiar për Mjedisin (LIFE) - OJL 192/2000 me ndryshuar Rregullores (EC) nr.1682/2004 e datës 15 shtator 2004 - OJL 308/2004

¹⁸Krah. Vendimi i Këshillit nr.1999/382/EC i datës 26 prill 1999 që krijoi fazën e dytë të programit të veprimit komunitar për formimin profesional “Leonardo da Vinci” - OJL 146/1999

¹⁹Krah. Rregullorja (EC) nr.1382/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit i datës 22 korrik 2003 për dhënien e ndihmave financiare komunitare për përmirësimin e funksionimit mjedisor të sistemit të transportit të mallrave (Programi Marko Polo) – OJL 196/2003

²⁰Krah. Korrigjimi i vendimit të Këshillit 2000/821/EC i datës 20 dhjetor 2000 për zbatimin e një programi për nxitjen e zhvillimit, shpërndarjes dhe promovimit të veprave audiovizive europiane (MEDIA Plus Zhvillimi, Shpërndarja dhe Promovimi) (2001-2005) (OJL 336 i datës 30.12.2000) — OJL 013/2001 ndryshuar nga vendimi nr.846/2004/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 29 prill 2004 - OJL 157/2004

²¹Krah. Vendimi nr.163/2001/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 19 janar 2001 për zbatimin e një programi trajnimi për profesionistët në sektorin e programeve audiovizive europiane (MEDIA-Training) (2001-2005) – OJL 026/2001 ndryshuar nga vendimi nr.845/2004 i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i 29 prill 2004-OJL 157/2004

22pritet miratimi — Cf. COM [2004]91 — 2004/0023/COD

23Krah. Vendimi nr.1513/20021/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 27 qershor 2002 lidhur me programin e gjashtë kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet demonstruese, duke kontribuar në krijimin e një hapësire kërkimore europiane dhe të risive(2002 to 2006) – OJL 232/2002

24Krah. Vendimi nr. 253/2000/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 24 janar 2000 që krijoi fazën e dytë të programit të veprimit komunitar në fushën e arsimit “Socrates” - OJL28/2000

25Krah. Vendimi nr.1031 /2000/EC i Parlamentit Europian dhe i Këshillit i datës 13 prill 2000 që krijoi programin e veprimit komunitar “Rinia” - OJL 117/2000

Në fund të paragrafit të parë, të pikës 3/1, të kapitullit III të vendimit nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Shitja e drejtpërdrejtë bëhet për qiramarrësit prodhues kur:

- kanë realizuar mbi 1 milion euro investime, në objektet e marra me qira;
- vlera e investuar e qiramarrësit kalon vlerën e objektit;
- kanë punësuar mbi 100 punëtorë;

- nuk kanë detyrime ndaj shtetit dhe nuk janë në konflikt gjyqësor, civil, për detyrime ndaj të tretëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.451, datë 16.6.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në kapitullin IV “Lidhja e kontratave”, në pikën 4.1 të shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Për shërbime të tilla komplekse si:

- shërbime lavanderie, shërbime kuzhine, shërbim për pastrim të mjediseve të brendshme e të jashtme dhe gjelbërim, kontratat të lidhen me afat deri në 5 vjet;
- shërbime mirëmbajtjeje e riparime pajisjesh, kontratat, pas mbarimit të afatit të garancisë, të lidhen me afat deri në 3 vjet.”.

1.Në kapitullin VII “Të fundit”, pika 7.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.1 Për fondet e Ministrisë së Integritit Europian dhe fondet e planifikuara për shërbimet komplekse, të përcaktuara në paragrafin e dytë të pikës 4.1 të këtij vendimi, për vitin 2005, afati i përcaktuar në pikën 3.1 shtyhet deri më 30 nëntor, duke përfshirë në të edhe lidhjen e kontratave përkatëse, ndërsa afati i përcaktuar në pikën 5.3, kapitulli V “Regjistri i realizimit të prokurimeve” shtyhet deri më 15 dhjetor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.4, datë 16.6.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kapitullin I “Enti prokurues dhe urdhri i prokurimit”, në fund të pikës 3, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në kontratat e shërbimeve me afat shumëvjeçar, enti prokurues mund të parashikojë klauzola, që bëjnë të mundur rishikimin e vlerës vjetore të kontratuar në fillim të vitit buxhetor pasardhës, në varësi të inflacionit zyrtar të publikuar nga institucioni përkatës.”.

2. Në kapitullin II “Procedurat e prokurimit”, në pikën 2, pas paragrafit të parë të shkronjës “dh”, “Prokurimi i drejtpërdrejtë”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Enti prokurues duhet të përzgjedhë kandidatin, i cili do të realizojë këtë procedurë nga një listë e përditësuar, rregullisht të paktën dy herë në vit dhe të publikuar në Buletin e Prokurimit publik. Përzgjedhja e kandidatit nga kjo listë të bëhet nga një komision, i ngritur posaçërisht për këtë qëllim nga titullari i entit prokurues.

Në rastin e parashikuar në shkronjën “gj” të pikës 1 të nenit 19 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, për përdorimin e procedurës së prokurimit të drejtpërdrejtë, enti prokurues në varësi të objektit të prokurimit, duhet të vërtetojë në organet e specializuara, si Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Markave dhe e Patentave apo në organe të tjera të specializuara, ekskluzivitetin e kandidatit të përzgjedhur për realizimin e këtij objekti.”.

3. Në kapitullin III “Dokumentet e tenderit”, në shkronjën “b”, “Pjesa e veçantë”, pika 3, “Për shërbimet”, bëhen ndryshimi dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e dytë shprehja “...mund të jetë...” zëvendësohet me shprehjen “...do të jetë...”

b) Pas paragrafit të tretë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në shkronjat “a” e “b” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, të ndryshuar, në rastin e shërbimeve komplekse si hoteleri, lavanderi e kuzhinë, përveçse si kriteret kualifikuese të përdoren edhe si kriteret për vlerësimin e kandidatëve. Enti prokurues duhet të përcaktojë qartë metodologjinë e vlerësimit të ofertave, duke u dhënë kandidatëve mundësi konkurrimi të barabarta.

Për të arritur te kandidati serioz dhe i besueshëm për realizimin e këtyre shërbimeve, enti prokurues duhet të tregojë se do të vlerësohet më shumë kandidati, që do të paraqesë avantazhe në anën profesionale, teknike, organizative, në personel, burime financiare, makineri dhe pajisjet, të cilat për efekt vlerësimi, detyrimisht, duhet të shprehen në terma monetarë. Vlera e investimit duhet të jetë pjesë e ofertës dhe zë një vend të rëndësishëm në përzgjedhjen e ofertës fituese nga enti prokurues.

Vlera e investimit dhe realizimi merren, tërësisht, përsipër nga sipërmarrësi dhe pasqyrohen qartë në kontratën e lidhur ndërmjet palëve. Në fund të kontratës, investimi i kryer dhe që nuk mund të hiqet pa dëmtuar sendin apo anën funksionale të tij, i mbetet entit prokurues, duke e zhveshur sipërmarrësin nga çdo përgjegjësi tjetër civile.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 23.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë